



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:254995

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06079277

C.nr.977/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Kaltrinë Haliti, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N., R., A., T., S., L., A., A., A., A., që të gjithë me mbiemër Ç., të gjithë nga Gjilani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Mustafë Musa nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, Lagja “Arbëria”, Rr.”Eduard Lir”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ardiana Bejtullahu Kastrati, juriste nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 01.08.2024 mori, ndërsa më datën 23.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N., R., A., T., S., L., A., A., A., A., që të gjithë me mbiemër Ç., të gjithë nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, Lagja “Arbëria”, Rr.”Eduard Lir, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial për shkak të vdekjes së të ndjerit Qerim Çoçaj, si rezultat i aksidentit të trafikut, të shkaktuar më datë 07.08.2019 të cilin e drejtonte M. A. nga Peja, me automjetin transportues "Scania", me targa 01-826-KI, të regjistruar me policë të sigurimit tek Kompania e Sigurimit “Prisig”, t’ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

A. Në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e anëtarit të familjes, t’ia paguaj shumat e specifikuar më poshtë:

I/a - Për paditësen N. Ç. në emër të dhimbjeve të pësuar shpirtërore, për humbjen e bashkëshortit, shumën totale prej 12,000.00 euro,

I/b – Për paditësin R. Ç., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të atit, shumën totale prej 10,000.00 euro;

I/c – Për paditësen T. Ç., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të atit, shumën totale prej 10,000.00 euro;

I/d- Për paditësen S. Ç., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të atit, shumën totale prej 10,000.00 euro;

I/e – Për paditësin L. Ç., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të atit, shumën totale prej 10,000.00 euro;

I/f – Për paditësen A. Ç., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të atit, shumën totale prej 10,000.00 euro.

REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të gjykuara si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, për kompensim e dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e anëtarit të familjes, edhe atë: për paditësen N. Ç., shuma prej 13,000.00 euro; për paditësit R., T., S., L. dhe A. Ç., shuma prej 10,000.00 për secilin veç e veç, ndërsa për paditëset A. Ç. (reja e të ndjerit), A. Ç. (mbesa e të ndjerit) si dhe A. dhe A. Ç. (nipërit e të ndjerit), shuma prej 20,000.00 euro për secilin veç e veç.

DETYROHET e paditura që paditësve të gjitha shumat e gjykuara në emër të dëmit jomaterial, t'ia paguaj në shumën prej 62,000.00 euro me kamatë ligjore-vjetore prej 8%, duke llogaritur nga data 13.08.2024 si datë e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

- B.** Në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj shumën e specifikuar si më poshtë:
- Për ngritjen e përmendores dhe shpenzimeve të varrimit, edhe atë, të rregullimit të varrit me material graniti, shumën prej 3,200.00 euro;

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që në emër të rentës së kapitalizuar (fitimit të humbur), si rezultat vdekjes së anëtarit të familjes si pasojë e aksidentit të komunikacionit, t'iu kompensohet dëmi në të holla duke filluar nga data 07.03.2019 (si ditë e shkaktimit të aksidentit), e deri më datën 21.05.2013 (si datë e arritjes së moshës së pensionimit të të ndjerit Q. C.), edhe atë: për paditësin R. C., shuma prej 89,297.37 euro, kurse për paditësit N., A., T., S., L., A., A., A., A., që të gjithë me mbiemër C., të gjithë nga Gjilani, shuma prej 3,200.00 euro për secilin veç e veç.

DETYROHET e paditura që paditësve shumën e gjykuar në emër të dëmit material, t'ia paguaj në shumë prej 3,200.00 euro me kamatë ligjore-vjetore prej 8%, duke llogaritur nga data 04.11.2019 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimi “Prisig”, me seli në Prishtinë, që paditësve N., R., A., T., S., L., A., A., A., A., që të gjithë me mbiemër C., të gjithë nga Gjilani, t'ia paguaj shpenzimet procedurale, dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 3,185.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Ar sy e t i m

Fillimisht paditësit më datë 04.11.2019, përmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar padi ndaj të paditurave Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë për kompensimin e dëmit.

Paditësit N., R., A., T., S., L., A., A., A., A., - Ç., që të gjithë nga Gjilani, përmes të autorizuarit të tyre av.Mustafë Musa, në padinë e ushtruar, kanë theksuar se me datë 07.08.2019, ka ndodhur aksident trafiku, në Qendër të Qytetit të Gjilanit në të cilën ka humbur jetën pa fajin e tij tani i ndjeri Q. Ç., ish nga Gjilani, i cili ka qenë në trotuar, para punëtorisë së tij, kur të njëjtin e ka goditur automjeti transportues i markës “Scania” me targa 01-826-KI, pronë e “V. GRROUP” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin e ka drejtuar Mustafë Avdija nga Peja, të cilit iu kishte çrregulluar sistemi i frenimit, me ç’rast nga lëndimet e marra i njëjti ka ndërruar jetë. Tutje kanë shtuar se automjeti transportues i cili ka shkaktuar këtë aksident, në momentin e aksidentit ka qenë i pa regjistruar dhe i pa siguruar. Kanë theksuar edhe se i ndjeri ka qenë pronar i biznesit individual N.T.P “Vëllezërit Ç.”, i regjistruar që nga viti 2000, është marrë me tregti me pakicë të bukës, ëmbëlsirave dhe produkteve prej miellit dhe sheqerit si dhe produkteve të tjera ushqimore, të cilin aktivitet e kishte zhvilluar në dy dyqane të specializuara, njërin në rrugën “Isa Boletini 1” në Gjilan dhe tjetrin në rrugën “Marie Shllaku” p.n, në Gjilan. Meqë të ndjerin e prisnin detyrime të mëdha për mbarëvajtjen e biznesit të tij, përmes padisë, i autorizuari i paditësve ka kërkuar edhe fitimin e humbur si pasojë e asaj se menaxhimi i biznesit sikur të ishte gjallë i ndjeri do të funksiononte ndryshe. Po ashtu në padi theksohet se paditësit i janë drejtuar të paditurave për kompensimin e dëmit në procedurë jashtëgjyqësore, por që, të njëjtat kanë deklaruar se nuk qëndron detyrimi i tyre për kompensimin e këtij rasti.

Nga gjykata kanë kërkuar që të aprovet kërkesëpadija e paditësve dhe të detyrohen të paditurat (Byroja Kosovare e Sigurimit dhe Kompania e Sigurimeve Prisig), që të dyja me seli në Prishtinë, që paditësve në mënyrë solidare t’ia paguaj shumat si në vijim: në emër të dëmit jomaterial, për bashkëshorten N., shumën prej 25.000.00 euro; për djalin R., shumën prej 20.000.00 euro; për vajzën A., shumën prej 20.000.00 euro; vajzën T., shumën prej 20.000.00 euro; vajzën S., shumën prej 20.000.00 euro; djalin L., shumën prej 20.000.00 euro; vajzën A., shumën prej 20.000.00 euro; mbesën A., shumën prej 20.000.00 euro; nipin A., shumën prej 20.000.00 euro si dhe nipin A., shumën prej 20.000.00 euro, kurse në emër të dëmit material, për fitimin e humbur, shumën prej 116.040.00 euro dhe për ngritjen e përmendores, shumën prej 3,200.00 euro, të gjitha këto me kamatë 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, në afat kohor prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

I autorizuari i paditësve në seancën përgatitore të mbajtur më datën 22.04.2024 ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv, ashtu që, ka tërhequr padinë sa i përket të paditurës së parë, gjegjësisht Byrosë Kosovare të Sigurimit me seli në Prishtinë si dhe për bazën e fitimit të humbur, paditës do të jetë N.T.P “Vëllezërit Ç.”, me seli në Gjilan, me pronar R. Q. Ç. nga

Gjilani, për çka, e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, që paditësit Refki, t’ia kompensojë fitimin e humbur në shumë prej 116,040.00 euro, me kamatë 8% duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata me aktvendimin e saj procedural të marrë në seancën kryesore të datës 22.04.2024, ka lejuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, ashtu që, palë e paditur do të jetë vetëm Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë.

Në shqyrtimet gjyqësore dhe në fjalën e tij përfundimtare, i autorizuari i paditësve ka deklaruar se paraardhësi i paditësve, tani i ndjeri Q. Ç., ish nga Gjilani, ka humbur jetën në aksidentin e trafikut në Qendër të Gjilanit më datën 07.08.2019 pa fajin e tij, kur të njëjtin befasisht e ka goditur automjeti transportues i markës “Scania” të cilin e kishte drejtuar Mustafë Avdijaj nga Peja, i cili me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 vitesh e 8 muaj, të cilin aktgjykim e kishte ndryshuar Gjykata e Apelit me nr.PA1.nr. 440/2020, të datës 13.10.2020, dhe të përmendurin e kishte gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 vitesh. Ka theksuar se automjeti transportues i cili ka shkaktuar aksidentin, ka qenë i siguruar te e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, në bazë të policës nr.0006916141, me datën 28.01.2020, e që i ndjeri ka jetuar në bashkësi familjare me tani paditësit. Bazuar në ekspertizën aktuaristike-financiare, për shkak të vdekjes së të ndjerit Q. Ç., në emër të fitimit të humbur, ka kërkuar shumën prej 116,040.00 euro; në emër të përmendores, shumën prej 3,200.00 euro; në emër të rentës së kapitalizuar, shumën prej 89,297.37 euro; në emër të ndërtimit të varrezës, shumën prej 3,200.00 euro. Pra, e paditura duhet t’ia kompensoj në emër të dëmit material, paditësit R. Ç., shumën prej 89,297.37 euro dhe të gjithë paditësve shumën prej 3,200.00 euro si dhe dëmin jo material të gjithë paditësve për shkak të vdekjes së bashkëshortit, babait dhe gjyshit, për dhimbjet e tyre shpirtërore, në shumën e kërkuar si në padi.

Nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësve në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësve për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial t’ia paguaj shumat e përcaktuara si më lartë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 650.00 euro; për taksën gjyqësore, shumën prej 1,000.00 euro, për tre përfaqësime në seanca gjyqësore, shumën prej 2,535.00 euro (1x845.00 euro), apo shumën e përgjithshme prej 3,185.00 euro.

E autorizuar e të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Prisig”, Ardiana Bejtullahu Kastrati, juriste nga Prishtina në shqyrtimet gjyqësore dhe fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se e paditura në tërësi e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve si për nga baza, ashtu edhe për nga lartësia. Ka theksuar se në bazë të provave të administruara, tek paditësit, të njëjtit nuk kanë paraqitur fare kërkesë për kompensim të dëmit në procedurë administrative dhe se vlera e kërkuar në emër të dhimbjeve shpirtërore në raport me paditësit N. C., R. C., A. C., T. C. S. C., L. C. dhe A. C. është jashtëzakonisht e lartë. E paditura e kundërshton në tërësi padinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, për dhimbjet shpirtërore për vdekjen e familjarit, për

paditësit A. C. (reja), A. C. (mbesa), A. C. (nipi) dhe A. C. (nipi), sepse bazuar në dispozitat e LMD-së, në mënyrë taksative specifikohen personat të cilët kanë të drejtë në kompensim për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes. Tutje, ka shtuar se bazuar në provat e administruara, është vërtetuar se kërkesëpadia e paditëses N.T.P “Vëllezërit Ç.” është parashkruar, sepse aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 07.03.2019, ndërsa padia e paditësve është parashtruar më datë 22.04.2022, ashtu që, kanë kaluar më tepër se pesë vite nga shkaktimi i aksidentit, dhe më shumë se 3 vjet nga dita kur të njejtit kanë patur dijeni për kërkesën, që do të thotë se ka kaluar afati subjektiv dhe objektiv i parashkrimit. E paditura njëkohësisht ka kundërshtuar edhe fitimin e humbur të kërkuar nga ana e paditësve duke u arsyetuar në atë se i ndjeri pas vetes nuk ka lënë asnjë fëmijë të mitur, e që me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet që të kërkohej fitimi i humbur në emër të vdekjes së babait të pronarit të biznesit, e po ashtu, me asnjë dispozitë nuk parashihet e drejta për kompensimin e dëmit material për fitim të humbur për shkak të detyrimeve bankare, apo e drejta që të kërkohej fitimi i humbur mbi bazën e pagës për biznesin. Gjithashtu, e paditura ka kundërshtuar edhe kërkesën për ngritjen e përmendores në vlerë prej 3,200.00 euro për shkak se nuk është vërtetuar se kujt i takon e drejta lidhur me këtë kërkesë, ndërsa nga profaktura e dorëzuar, nuk dëshmohej pagesa e së njejtës. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës gjyqësore, gjykatës i ka propozuar që me rastin e vendosjes të aplikojë dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, ka administruar provat materiale dhe atë: Raporti i aksidentit nr.2019-CR-100, i datës 07.03.2019; Certifikata e vdekjes nr.107, e datës 29.03.2019; Certifikata e biznesit ARBK nr.810259079, e datës 11.07.2000; Pasqyra e trustit, e datës 17.05.2019; Aktakuza e PTHGJ PP.II.nr.346/2019, e datës 27.05.2019; Deklarata e bashkësisë familjare nr. 4/4001, e datës 29.03.2019; Certifikata e martesës nr.526, e datës 19.03.2019; Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile për të ndjerin Q. nr. E 23340392, e datës 19.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen N., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësin R., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 20.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen Teutë; e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësin L., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësin A., e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësin Arianit, e datës 29.03.2019; Certifikata e lindjes për paditësen Sarandë, e datës 29.03.2019; Oferta për rregullimin e përmendores, e datës 08.04.2019; Ekspertiza e Aktuaristikës financiare e ekspertit A. B., e datës 25.06.2019; Oferta e firmës N.T.P “G. Store”, e datës 08.04.2019; Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. 10-942-73907/17, me nr të prot. 951-1526-2017, i datës 10.08.2017; Raporti i bankës BKT për qarkullimin bankar të të ndjerit R., i datës 29.03.2019; Kontrata mbi hipotekën nr. 5050/2017, me referencën nr.1124/17, e datës 04.08.2017; Marrëveshja mbi kredinë me Raiffaisen Bank, e datës 10.07.2017, me shtojcën e kolateralit të lënë peng; Kontrata e kredisë për biznes nr.50058290, e datës 31.12.2014; Kontrata e kredisë për biznes nr.50058950, e datës 29.05.2015; Planifikimi i kthimit të kredisë nr. 50058950, e datës 29.05.2015; Kontrata e kredisë për biznes nr.50059995, e datës 25.04.2016; Plani i kthimit të kredisë, me numër dhe datë të njejtë; Kontrata e kredisë bankare nr.7601237474, e datës 25.07.2017; Raporti bankar i Raiffaisen

Bank, i datës 29.03.2019; Raporti i QPS-së në Gjilan, me numër 02-46, i datës 11.01.2017; Regjistri i punëtorëve dhe paga, e datës 11.01.2017; Raporti i Spitalit të Gjilanit Emergjencia, nr.5627, e datës 07.06.2019; Certifikata e vdekjes, e datës 19.03.2019 lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë; Vërtetimi mjekësor i vdekjes për të ndjerin Q., pa numër dhe datë; Ekspertiza e ekspertit financiar, e datës 14.06.2024.

Nga Certifikata e vdekjes nr.107, e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se Q. Ç., nga i ati R. Ç., dhe e ëma A. Ç., ka lindur më datë 21.07.1966 në Gj., kurse ka vdekur më datë 07.03.2019 në Gjilan.

Nga Certifikata e biznesit ARBK nr.810259079, e datës 11.07.2000, gjykata ka vërtetuar faktin se N.T.P. “Vëllezërit Ç.” është emri tregtar, përmes të cilit i ndjeri Q. Ç. ka regjistruar biznesin e tij individual me emrin e biznesit Q. Ç. B.I, më datë 11.07.2000.

Nga Pasqyra e trustit, e datës 17.05.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se Q. Ç., në kuadër të bilancit fillestar ka shumë prej 9,443.53 euro, ashtu që, kontributet janë në shumë prej 750.00 euro dhe kthimi i investimeve kap shifrën prej 11.39 euro, e që bilanci përfundimtar arrin vlerën prej 10,204.92 euro.

Nga Aktakuza e PTHGJ PP.II.nr.346/2019, e datës 27.05.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se M. A. nga pakujdesia ka kryer veprën penale “Rrezikim i trafikut publik”, nga neni 370, paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, për çka lëndime të natyrës vdekjeprurëse, u shkaktohen të ndjerëve Q. Ç. dhe F. I..

Nga Deklarata e bashkësisë familjare nr. 4/4001, e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se N. Ç. është e veja e të ndjerit Q. Ç., R. Ç. dhe L. Ç. janë djemtë e të ndjerit, T. Ç., S. Ç. dhe A. Ç. janë vajzat e të ndjerit. A. Ç. është reja e të ndjerit, A. Ç. është mbesa e të ndjerit kurse A. Ç. dhe A. Ç. janë nipërit e të ndjerit.

Nga Certifikata e martesës nr.526, e datës 19.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se Q. Ç., i lindur më datë 21.07.1966 në Gjonaj, nga i ati R. Ç. dhe e ëma A. Ç., më datën 02.11.1990 ka lidhur martesë me N. C., e lindur më 25.01.1967 në Romajë, nga i ati H. C. dhe e ëma N. C..

Nga Ekstrakti Regjistri Qendror i Gjendjes Civile për të ndjerin Q. nr. E 23340392, e datës 19.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i ndjeri Q. Ç. ka qenë i martuar me N. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen N. Ç., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se N. Ç., me numër personal 1012049354, ka lindur më 25.01.1967 në Romajë, nga i ati H. C. dhe e ëma N. C..

Nga Certifikata e lindjes për paditësin R., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se R. Ç. me numër personal, ka lindur më datë 07.04.1984 në Prizren, nga i ati Q. Ç. dhe e ëma N. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 20.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se A. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 01.03.1988 në Prizren, nga i ati B. O. dhe e ëma L. O..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen Teutë, e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se T. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 30.08.1988 në Prizren, nga i ati Q. Ç. dhe e ëma N. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësin L., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se L. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 06.01.1993 në Prizren, nga i ati Q. Ç. dhe e ëma N. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se A. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 23.08.1995 në Prizren, nga i ati Q. Ç. dhe e ëma N. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen A., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se A. Ç., me numër personal, ka lindur në Gjilan, nga i ati R. Ç. dhe e ëma A. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësin A., e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se A. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 17.10.2008 në Gjilan, nga i ati R. Ç. dhe e ëma A. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësin Arianit, e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se A. Ç., me numër personal, ka lindur më datë 25.02.2012 në Gjilan, nga i ati R. Ç. dhe e ëma A. Ç..

Nga Certifikata e lindjes për paditësen Sarandë, e datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se S. Ç., me numër personal, ka lindur më datën 29.10.1990 në Prizren, nga i ati Q. Ç. dhe e ëma N. Ç..

Nga Oferta për rregullimin e përmendores, e datës 08.04.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se të ndjerit Q. Ç., i është rregulluar përmendorja në vlerë prej 3,200.00 euro.

Nga Oferta e firmës N.T.P “G. Store”, e datës 08.04.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se varreza prej materialit të granitit e ndërtuar për të ndjerin Q. C., është në shumën prej 3,200.00 euro.

Nga Aktvendimi mbi Regjistrimin e Hipotekës nr. 10-942-73907/17, me nr të prot. 951-1526-2017, i datës 10.08.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se është lejuar regjistrimi i Hipotekës së rendit të parë në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme, mbi pronën e paluajtshme-njësinë kadastrale O-70403013-03300-0-94-1-14-0, e evidentuar në emër të H. (R.) H. nga Zhegra, për sigurimin e kredisë, në shumë prej 35,000.00 euro, në periudhë prej 15 vitesh, ashtu që në cilësi të debitorit paraqitet Q. Ç..

Nga Raporti i bankës BKT për qarkullimin bankar të të ndjerit R., i datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i ndjeri Q. Ç. ka lënë kredi në shumën prej 285.00 eurosh çdo muaj në bankën BKT, e që, debiti kap vlerën prej 48,849.24 euro kurse kredia kap shifrën prej 48,853.00 euro.

Nga Kontrata mbi hipotekën nr. 5050/2017, me referencën nr.1124/17, e datës 04.08.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se Banka Kombëtare Tregtare në cilësi të kreditorit hipotekues, përfaqësuar nga N. A. S. dhe H. R. H. – pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar (hipoteklënësi i njësisë kadastrale O-70403013-03300-0-94-1-14-0 ZK Gjilan), lidhin kontratë hipoteke, ashtu që, pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar, siguron kreditorin hipotekues për plotësimin e detyrimeve të parapara me Kontratën e kredisë bankare nr.7601237474, të datës 25.07.2017, në shumën prej 35,000.00 euro ndërmjet bankës si kredidhënës dhe kredimarrësit Q. Ç. dhe N. Ç. si bashkëkredimarrëse.

Nga Marrëveshja mbi kredinë me Raiffaisen Bank, e datës 10.07.2017, me shtojcën e kolateralit të lënë peng, gjykata ka vërtetuar faktin se Raiffeisen Bank Kosovo, në cilësi të kredidhënësit, me seli në Prishtinë dhe D.P.Z. “Vëllezërit Ç.”, përfaqësuar nga Q. Ç. në cilësi të kredimarrësit dhe garantuesit personal, si dhe L. Ç. në cilësi të bashkëkredimarrësit dakordohen që kredidhënësi në pajtim me kushtet dhe afatet e kësaj marrëveshje, do t’i jep kredi kredimarrësit në shumën prej 30,000.00 euro, ashtu që, qëllimi i kësaj kredie konsiston në financimin e blerjes së inventarit dhe paisjeve, e që, afati për kthimin e kësaj kredie është 36 muaj.

Nga Kontrata e kredisë për biznes nr.50058290, e datës 31.12.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se Pro Credit Bank, sh.a e regjistruar në Kosovë, me adresë në Bulevardin Nënë Tereza dhe Vëllezërit C. D.P.Z, biznes individual dhe R. Ç., në cilësi të bashkëkredimarrësit, lidhin kontratë për kredi, ashtu që, kjo kontratë e kredisë si kontratë aksesore, buron nga Kontrata Kornizë nr. FË.20, e datës 09.07.2013 dhe Shtojca nr. 1, datë 23.12.2014, e që, kjo kredi do të shfrytëzohet vetëm për blerjen e objektit për nevoja të biznesit, parapagim në ProCredit Bank dhe renovim i objektit të biznesit, me çka, në kuadër të pengut është shuma prej 200,000.00 euro me asete dhe inventar të përcaktuar sipas listës së kolateralit të përcaktuar si në Annexin 1.

Nga Kontrata e kredisë për biznes nr.50058950, e datës 29.05.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se ProCredit Bank në cilësi të kredidhënësit dhe Vëllezërit Ç. D.P.Z, në cilësi të kredimarrësit si dhe R. Ç. në cilësi të bashkëkredimarrësit, lidhin kontratë të kredisë, ashtu që, kjo kontratë do të jetë si kontratë aksesore e cila buron nga Kontrata Kornizë e Kredisë nr. FË50.20, e datës 09.07.2013 dhe shtojca nr. 1, e datës 23.12.2014, ashtu që kredia mund të përdoret vetëm për qëllimin e caktuar i cili konsiston në blerjen e objektit për nevoja të biznesit.

Nga Planifikimi i kthimit të kredisë nr. 50058950, e datës 29.05.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se Vëllezërit Ç. D.P.Z, duke filluar nga muaji korrik i vitit 2015, e deri në muajin janar

të vitit 2025, duhet të paguajnë çdo muaj shumën prej 1,096.01 euro si rezultat i marrjes së kredisë në ProCredit Bank.

Nga Kontrata e kredisë për biznes nr.50059995, e datës 25.04.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se ProCredit Bank sh.a, e regjistruar në Kosovë, me adresë në Bulevardin Nënë Tereza, me seli në Prishtinë, në cilësi të kredidhënëses dhe Vëllezërit Ç. D.P.Z me seli në Gjilan, në cilësi të kredimarrësit si dhe R. Ç. në cilësi të bashkëkredimarrësit, lidhin kontratë të kredisë për biznes, ashtu që, kjo kontratë është në përputhje me Kontratat e Kolateralit- kontrata e hipotekës nr. rendor LRP 1770/2013, ref.nr.130/2013 e datës 10.07.2013 dhe aneks i kontratës së hipotekës LRP.nr.5308/2014, ref.nr.1217/2014, e datës 23.12.2014, aneks i kontratës së hipotekës LRP.nr.1714/2016, nr. ref. LRP.nr.388/2016, e datës 05.04.2016 dhe kontratës së pengut nr.50059995, të datës 25.04.2016.

Nga Plani i kthimit të kredisë, me numër dhe datë të njejtë, gjykata ka vërtetuar faktin se Vëllezërit Ç. D.P.Z, me seli në Gjilan, duke filluar nga data 25.05.2016, e deri më 25.01.2025 duhet t'ia paguajnë ProCredit Bankës, shumën prej 981.35 euro, si rezultat i kredisë së marrë.

Nga Kontrata e kredisë bankare nr.7601237474, e datës 25.07.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se Banka Kombëtare Tregtare me seli në Prishtinë, në cilësi të kredidhënëses dhe z. Q. Ç. në cilësi të kredimarrësit, znj. N. Ç., në cilësi të bashkëkredimarrëses, si dhe z. H. H. dhe znj. V. M., në cilësi të garantuesve lidhin kontratë kredie, ashtu që, kredimarrësi i ka kërkuar bankës lëvrimin e një kredie në shumën prej 35,000.00 euro, destinimi i së cilës është kredi për shtëpi- blerje e banesës, e që, kredimarrësi dhe garantuesi kundrejt kredisë së dhënë dhe limitit të kartës së kreditit të lëshuar nga banka, sigurojnë këtë të fundit me anë të garancisë, përfaqësuar nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme, ashtu që, garancia me pasuri të paluajtshme është lokali i identifikuar me certifikatën e pronës me numër të lëndës 951-623-2017 dhe me numër të objektit O-70403013-03300-0-94-1-14-0, me sipërfaqe prej 186 m, ZK Gjilan, në vendin e quajtur “Te Inkubatori i Biznesit”, K.K Gjilan, me pronar, z.H. (R.) H., ashtu që, vlera totale për këtë paluajtshmëri, arrin shumën prej 58,000.00 euro.

Nga Raporti bankar i Raiffaisen Bank, i datës 29.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se gjendja fillestare e e biznesit individual “Vëllezërit Ç.”, për periudhën nga data 02.01.2018 deri më 29.03.2019, kap shumën prej 4,275.13 euro, ashtu që, total debi është -21,410.06 euro, kredia në total përfshin shumën prej 18,441.25 euro, ndërsa gjendja përmbyllëse është 1,306.32 euro, kurse nga data 01.01.2017 deri më datën 29.03.2019, gjendja fillestare arrin shumën prej 23.81 euro, total debi arrin shumën prej 40,977.93 euro, kredia në total kap shumën prej 45,229.25 euro, ndërsa gjendja përmbyllëse arrin shifrën prej 4,275.13 euro.

Nga Raporti i QPS-së në Gjilan, me numër 02-46, i datës 11.01.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se Furra Piceria “Vëllezërit Ç.” përmes Mursel Zymberit – Drejtor i QPS-së, nga sektori i Asistencës Sociale, ka bërë përzgjedhjen e familjeve me gjendje të rëndë sociale, të cilët do të jenë përfitues të donacionit nga Furra Piceria “Vëllezërit C.”, në shumën prej 5 bukë në ditë, për vitin 2017, ashtu që në mesin e familjarëve përfitues janë: A. K., A. Z., A. R., L. B., T. H., Sh. M., E. S., A. J., I. A., B. D. dhe N. A. me anëtarët e tyre.

Nga Regjistri i punëtorëve dhe paga, e datës 11.01.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se 21 punëtorët të cilët kanë punuar tek Biznesi Individual “Vëllezërit Ç.,” kanë marrë paga të rregullta mujore duke paguar edhe kontributet.

Nga Raporti i Spitalit të Gjilanit Emergjencia, nr.5627, e datës 07.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se Q. Ç. në orën 14:15 min ka arritur në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan si rezultat i aksidentit në trafikun e komunikacionit të cilit i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor, ashtu që, ka përfunduar pa shenja jete. Të njëjtit i është caktuar diagnoza përfundimtare “Exitus Letalis” dhe është udhëzuar që t’i bëhet autopsia.

Nga Certifikata e vdekjes, e datës 19.03.2019 lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se gjendja e cila e ka sjell deri te shkaktari i drejtpërdrejt i vdekjes Q. Ç. është Ruptura aortae, hepatis pp. aksident trafiku.

Nga Vërtetimi mjekësor i vdekjes për të ndjerin Q., pa numër dhe datë, gjykata ka vërtetuar faktin se vdekja e të ndjerit Qerim Cocaj, është konstatuar nga ana e z. H., specialist në Mjekësinë Emergjente.

Nga Ekspertiza e ekspertit financiar I. T., e datës 14.06.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se pasqyra e trustit për të ndjerin Q. Ç., për periudhën kohore nga data 14.05.2018-17.05.2019, vërehet se të ardhurat personale të tij janë të deklaruara dhe të paguara në trust, gjë që arrijnë vlerën prej 2,500.00 euro për çdo tremujor, apo 833.33 euro në muaj (periudha e raportimit 17.05.2019). Mbi bazën e kësaj është llogaritur renta e kapitalizuar, nga data e aksidentit, deri në arritjen e moshës së pensionimit), ashtu që, kjo llogaritje është bërë duke aplikuar Tabelat e moralitetit me numra kumulativ, të aplikueshme në BQK e Kosovës, me kamatën diskonte 3% në vit, rregull që vlen nëse palët në kontest pajtohen që për periudhën e ardhshme prej 07.03.2019 e tutje derisa ekzistojnë kushtet ligjore, renta mujore si më sipër, paditësit t’i paguhet menjëherë në formë të kapitalizuar. Duke u bazuar në këtë, renta e kapitalizuar nga data e aksidentit 07.03.2019 e deri në datën e pensionimit 21.05.2031, është në shumën prej 89,297.37 euro. Mbështetur në ofertën e Kompanisë BI “G. S.,” varrezë graniti, më datën 08.04.2019, shpenzimet për ndërtimin e varrezës prej graniti, dhe sipërfaqja e punuar nga ana e biznesit që ka punuar me këtë veprimtari, kap shumën prej 3,200.00 euro, ashtu që, dëmi i shkaktuar mbi bazën e fitimit të humbur në formën e rentës së kapitalizuar dhe shpenzimeve të varrimit, është 92,497.37 euro.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse fakti se më datën 14.12.2019 ka ndodhur një aksident. Po ashtu, gjykata

vlerëson se në rastin konkret në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Gjykata, rrjedhimisht nga gjendja e vërtetuar faktike, erdh në përfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në arsyet ligjore si ne vijim: me nenin 9 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 , përcaktohet “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit”, po ashtu me nenin 918 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të cekur me lartë përcaktohet” Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër”, ndërsa në nenin 919, par.1 të këtij ligji përcaktohet “Ngjarja, duke marrë parasysh se për cilën kontraktohet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë i ardhshëm, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti ekskluziv i kontraktuesve”. Me dispozitën e nenit 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) me është paraparë se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, po ashtu me nenin 137 të këtij ligji përkufizohet se çka përfshin dëmi “dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, po ashtu me nenin 140 parashihet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Me dispozitat e nenit 169 dhe 172 të LMD-së është paraparë saktë se në rast dëmtimi duhet të bëhet kompensimi i dëmit dhe të bëhet rikthimi në gjendje të mëparshme, e nëse kjo nuk është e mundur të bëhet kompensimi në të holla. Me nenin 176 paragrafi 1 të LMD-së “ I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar” ndërsa me paragrafin 3 të po këtij neni është paraparë që “ Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi të dëmtuarit , gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit” Sipas dispozitës së nenit 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji është parashikuar se për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.

Gjykata, me rastin e vendosjes duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, si dispozita materiale ka aplikuar edhe nenet: 136. par.1, 137, 140, 159 par.1, 169. 172,179 183 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD). Me nenin 136 par.1 të LMD-së, është paraparë se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, po ashtu me nenin 137 të këtij ligji, është paraparë se “ Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes

psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Po ashtu, me nenin 140 parashihet se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, kurse sipas nenit 159 parag.1, parashihet se ”Në rast aksidenti nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”. Po ashtu, me nenin 169 dhe 172 të po këtij ligji, është paraparë saktë se në rast dëmtimi duhet të bëhet kompensimi i dëmit dhe të bëhet rikthimi në gjendje të mëparshme, e nëse kjo nuk është e mundur të bëhet kompensimi në të holla. Me dispozitat e nenit 184 par. 1 të LPK-së parashihet se ”Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore”, ndërsa me par. 2 po të të njëjtit nen parashihet ”Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”. Me dispozitën e nenit 177 par.1 të LMD-së parashihet se “Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që ti shpërblej shpenzimet e zakonshme të vorrimit të tij”. Me dispozitën e nenit 178 të LMD-së parashihet se “Personi të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe aj që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkoj ushqim nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose ndihmës. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla shuma e të cilës caktohet duke marrur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jenë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi i të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetet gjallë. Sipas nenit 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji, është parashikuar se për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridiko civile, mori për bazë edhe nenin 319.1 të LPK-së, në të cilin shprehimisht thuhet se “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, si dhe nenin 322.2 të LPK-së, në të cilin thuhet se “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësve, pasi gjeti se paditësit kanë vërtetuar se me aksidentin e shkaktuar më datë 07.08.2019, përgjegjësia bie mbi të paditurën (këtu Kompaninë e Sigurimit), me ç`rast të njëjtit i ka lindur e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky aksident. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, e duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura te LMD-së, e me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nga te sipërpërmendurat, gjykata erdhi deri tek përfundimi se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, dhe e obligoi te paditurën të ua shpërblej dëmin për formën e demit jo material për dhimbje shpirtërore e për shkak të humbjes se anëtarit të familjes, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 184 nen al. 2 të LMD-së. Me rastin e vendosjes për

kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin që me të njëjtin, të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror, prandaj, gjykata ua caktoi shumat paditësve N., R., A., T., S., L., A., A., A. dhe A. Ç., që të gjithë nga Gjilani si në al.I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas vlerësimit të provave të lartcekura, si dhe thënieve të palës paditëse të parashtruara në padi dhe gjatë seancave të mbajtura, vlerëson se në rastin konkret në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se më datën 07.08.2019 ka ndodhur një aksident trafiku, ku nga ky aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore Q. C., e që si rezultat i lëndimeve të marra, i njejti është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, ashtu që, pas kontaktimit nga ana e mjekëve, është konstatuar se i njejti është pa shenja jetë, gjë e cila vërtetohet edhe nga Raporti i Spitalit të Gjilanit Emergjencia, nr.5627, e datës 07.06.2019, si dhe nga Certifikata e vdekjes, e datës 19.03.2019 lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, përmes së cilës konstatohet se gjendja e cila e ka sjell deri te shkaktari i drejtpërdrejt i vdekjes Q. Ç. është Ruptura aortae, hepatis pp. aksident trafiku. Po ashtu për gjykatën nuk ishte kontestuese as legjitimiteti i palës sepse shkaktari i aksidentit kishte mjetin transportues të siguruar tek e paditura në momentin të cilin e ka shkaktuar aksidentin nga edhe rrjedh e drejta e paditësve për të kërkuar kompensimin e dëmit moral dhe material për humbjen e anëtarit të familjes së tyre.

Megjithatë, kontestuese për gjykatën lartësia e kërkesëpadi së paditësve, duke iu referuar faktit nëse shumat e kërkuara në kërkesëpadi i përgjigjen satisfaksionit emocional, referuar këtu dhimbjeve shpirtërore për humbjen e jetesës së njeriut të dashur të tyre. Gjithashtu kontestuese për gjykatën paraqitet edhe parashkrimi i kërkesëpadi së paditësve, lidhur me atë nëse padia e parashtruar si rezultat i aksidentit të shkaktuar në komunikacion, ruan akoma realizimin e të drejtës subjektive të paditësve apo e njejta si rezultat i konsumimit të afatit kohor është vjetërsuar.

Gjykata ia fali në tërësi besimin ekspertizave të administruara në këtë çështje kontestimore, edhe atë ekspertizën financiare dhe atë të aktuaristikës, pasi gjeti se të njëjtat janë punuar nga specialist të fushës përkatëse, janë punuar në mënyrë profesionale dhe i janë përgjigjur çështjeve të parashtruara nga të njëjtit duke përdorur metodat e duhura, ashtu që në bazë të ekspertizës financiare, gjykata ka vërtetuar faktin se pasqyra e trustit për të ndjerin Q. Ç., për periudhën kohore nga data 14.05.2018-17.05.2019, vërehet se të ardhurat personale të tij janë të deklaruara dhe të paguara në trust, gjë që arrijnë vlerën prej 2,500.00 euro për çdo tremujor, apo 833.33 euro në muaj (periudha e raportimit 17.05.2019). Mbi bazën e kësaj është llogaritur renta e kapitalizuar, nga data e aksidentit, deri në arritjen e moshës së pensionimit), ashtu që, kjo llogaritje është bërë duke aplikuar Tabelat e moralitetit me numra kumulativ, të aplikueshme në BQK e Kosovës, me kamatën diskonte 3% në vit, rregull që vlen nëse palët në kontest pajtohen që për periudhën e ardhshme prej 07.03.2019 e tutje derisa ekzistojnë kushtet ligjore, renta mujore si më sipër, paditësit t'i paguhet menjëherë në formë të kapitalizuar. Duke u bazuar në këtë, renta e kapitalizuar nga data e aksidentit 07.03.2019 e deri në datën e

pensionimit 21.05.2031, është në shumën prej 89,297.37 euro. Mbështetur në ofertën e Kompanisë BI “G. S.”, varrezë graniti, më datën 08.04.2019, shpenzimet për ndërtimin e varrezës prej graniti, dhe sipërfaqja e punuar nga ana e biznesit që ka punuar me këtë veprimtari, kap shumën prej 3,200.00 euro, ashtu që, dëmi i shkaktuar mbi bazën e fitimit të humbur në formën e rentës së kapitalizuar dhe shpenzimeve të varrimit, është 92,497.37 euro.

Gjykata, rrjedhimisht sa i përket te drejtës ne kompensim te demit jomaterial per shkak te dhimbjeve te pësuar shpirtërore paditësve të cilët kanë jetuar në bashkësi familjare me të ndjerin Qerim Cocaj, ashtu që, me të ndjerin, jetesë të përbashkët kanë patur N., R., A., T., S., L., A., A., A. dhe A. C., gjë e cila argumentohet edhe nga Deklarata e bashkësisë familjare nr. 4/4001, e datës 29.03.2019, e duke iu referuar nenit 184, par.3 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr.04/L-077, ne te cilin përcaktohet “Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore”, ndërsa sa i përket lartësisë se kompensimit te demit jo material për dhimbjet e pësuar shpirtërore për paditësit për shkak te vdekjes se te ndjerit duke marre parasysh lidhjet familjare, emocionale, tronditjet psikike qe ka shkaktuar vdekja e te ndjerit tek paditësit, intensitetin, kohëzgjatjen dhe pasojat tjera te demit jo material te manifestuara ne forme te dhimbjeve shpirtërore, iu referua 184, par. 1 dhe 2 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve, ne te cilin përcaktohet “Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore”, si dhe ngritjen e përmendores dhe shpenzimet e varrimit, në shumën prej 3,200.00 euro, andaj ua njohu shumat si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Gjykata refuzoi shumën e të hollavë të kërkuara për shkak të kompensimit të demit jomaterial për paditëset A., A., A. dhe A. C., për faktin se A. është reja e të ndjerit, A. është mbesa e të ndjerit, kurse A. dhe A. C. janë nipërit e të ndjerit, ashtu që bazuar në nenin 184 par. 2. të LMD-së parashihet” Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”, për çka në mënyrë të qartë definohen personat të cilëve mund t`u bëhet kompensimi për shkak të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara nga humbja e ndonjë anëtari të familjes, andaj meqë kjo kategori e personave nuk bën pjesë si kategori kompensuese në kuadër të të drejtës së brendshme, gjykata të njejtës i ka refuzuar shumat e kërkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën është i pabazuar pretendimi i të paditurës se kërkesëpadia e paditësve është e përfshirë në parashkrim aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 07.03.2019, ndërsa padia e paditësve është parashtruar më datë 22.04.2022, ashtu që, kanë kaluar më tepër se pesë vite nga shkaktimi i aksidentit, dhe më shumë se 3 vjet nga dita kur të njejtit kanë patur dijeni për kërkesën, që do të thotë se ka kaluar afati subjektiv dhe objektiv i parashkrimit, sepse bazuar në nenin 358 të LMD-së thuhet se: “Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të demit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, si dhe në nenin 361.1 të po të njejtit ligj është e përcaktuar se: “gjitha kërkesat

që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”, çfarë na lë të kuptojmë se meqë vdekja e të ndjerit ka ardhur si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka rezultuar si pasojë e veprës penale “Rrezikim i trafikut publik”, nga neni 378, par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, gjë e cila lidhet me vepër penale, vijmë në konkludim se kërkesëpadia e paditësve nuk është e përfshirë në parashkrim, dhe se afati kohor brenda të cilit të njejtit e kanë ushtruar padinë në këtë gjykatë, rezulton në afat të vlefshëm kohor për realizimin e të drejtës subjektive të kërkuar me padi pasi që padia në gjykatë është ushtuar me datë 04.11.2019 e që nuk ndërlidhet fare me datën 22.04.2022.

Pretendimin e të paditurës për kundërshtimin e kërkesëpadiës sa i përket kompensimit të rentës së kapitalizuar, gjegjësisht fitimit të humbur për të paditurin R. Ç. në shumë prej 89,297.37 euro si dhe paditësve N., A., T., S., L., A., A., A. dhe A. C., secili veç e veç shumë prej 3,200.00 euro ngase gjykata nga certifikata e biznesit ka gjeti se e njehta është e regjistruar në emër të të ndjerit, dy muaj pas vdekjes së të njejtit si dhe bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, në të cilin shprehimisht thuhet se “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, si dhe nenin 322.2 të LPK-së, në të cilin thuhet se “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”, nuk kishte mundësi të vërtetonte se paditësit kishin pasur fitim të humbur si pasojë e vdekjes së anëtarit të familjes së tyre, meqë biznesi që tashmë administrohet nga ana e paditësve nuk është mbyllur dhe veprimtarinë e ushtron në mënyrë të njejtë sikurse i ndjeri të ishte gjallë, ashtu që, në mungesë të provave refuzoi kërkesëpadinë e paditësve si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerën e shumave të theksuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e mori duke u bazuar në Udhëzuesin për Caktimin e Kriteve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jo material të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me nr.41/2023, të datës 27.02.2023, ashtu që, bazuar në kriteret për caktimin e shumave të kërkuara si në padi, gjykata vendosi këto shuma bazuar në udhëzuesin në fjalë.

Nga të gjitha të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerësoi se shumat e kërkuara nga paditësi nuk pasqyrojnë një shumë që i përgjigjet realisht këtyre dhembjeve, tërë kjo duke u mbështetur praktikave të deritanishme. Gjykata ka parasysh se me shkaktimin e dëmit të paditësi, asnjë shumë nuk do të rivendos gjendjen e mëparshme të dhembjeve të përjetuara nga ana e tij, mirëpo njëkohësisht gjykata është e thirrur të gjejë një shumë që nuk do të tejkalonte qëllimin për çka kompensohet kjo shumë, ashtu që qëllimi i këtij kompensimi nuk konsiston në pasurim të paditësve, por që të arrijë një satisfaksion, në atë masë që paditësi të bëjë ekuilibrimin e gjendjes së tij shpirtërore dhe për aq sa mundet sanimin e të mirës së cënuar. Këto shuma të gjykuara janë në përputhje të plotë me natyrën e të mirës së cënuar dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit jomaterial, duke u bazuar edhe sipas mendimeve të ekspertëve mjekësor ortoped dhe psikiatër.

Përfundimisht, gjykata konsideron se lartësia e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial për paditësit është shpërblim real dhe objektiv dhe paraqet një formë të satisfaksionit që paditësit me këto mjete të shpërblehen për dhimbjen shpirtërore të të përjetuara me rastin e aksidentit dhe vdekjes së anëtarit të familjes.

Me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha kategoritë e caktuara të dëmit material dhe jomaterial ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar me bindje se kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, në këtë rast paditësin.

Sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara. Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen shkallës së dëmit të shkaktuar paditësve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë, e kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, kurse sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës të cilat i ka aprovuar palës paditëse gjykata është bazuar në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, duke ia njohur kërkesën për përparim të padisë, shumën prej 650.00 euro; për taksën gjyqësore, shumën prej 1,000.00 euro, për tre përfaqësime në seanca gjyqësore, shumën prej 2,535.00 euro (1x845.00 euro), apo shumën e përgjithshme prej 3,185.00 euro.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.977/2019, datë 23.08.2024

Gj y q t a r j a,
Kaltrinë Haliti

KËSHILLA JURIDIKE – Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:254995
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06079277